



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 1562/Prot.

Durrës, më 5.10.2023

VENDIM
Nr. 59, datë 5.10.2023

PËR

"Mbi ngritjen e Komisionit të Integritetit Akademik (KIA), në nivel Institucional, të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës"

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 46, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.685, datë 25.08.2010, 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës", të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", në Urdhërin nr.105, datë 23.3.2012 "Për miratimin e Rregullores për Etikën në Veprimtarinë Kërkimore dhe Botuese", në Kodin e Etikës dhe në Kodin e Etikës në Kërkimin Shkencor të UAMD-së, neni 12 pika 1 dhe pika 2, në relacionin nr.1522 prot., datë 2.10.2023, Senati Akademik;

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit për Integritetin Akademik (KIA), në nivel Institucional, të Universitetit "Aleksandër Moisiu".
2. Miratimin e Komisionit me përbërje prej 5(pesë) anëtarëve, pjesë e stafit akademik me kohë të plotë nga secila Njësi Kryesore, të cilët mbajnë titullin Profesor Doktor, për një mandat 2-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Miratimin për anëtarë, pa të drejtë vote, të 1 (një) specialisti të teknologjisë së informacionit, pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Akademike.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore.
 - Drejtuesit e Njësive Bazë.
 - Drejtoria e Shërbimeve Akademike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
Prof. Dr.Kseanela SOTIROFSKI

